

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR FALSIFIKIMIT TË MONEDHËS”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për luftën kundër falsifikimit të monedhës, nënshkruar në Gjenevë, në 20 prill 1929.

Kjo konventë siguron parandalimin dhe dënimin e veprës penale të falsifikimit të monedhës, nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare, duke shkëmbyer informacion me anë të Zyrës Qendrore. Ky bashkëpunim pritet të realizojë objektivat në lidhje me evidentimin e shkeljeve dhe marrjen e masave të përbashkëta në luftën kundër falsifikimit të monedhës, duke respektuar legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për luftën kundër falsifikimit të monedhës” është planifikuar në Programin Kombëtar të Integritimit Evropian, kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”.

Gjithashtu, projektligji është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj konvente janë në lidhje me luftën kundër falsifikimit të monedhës, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit.

Palët do të ndërmarrin masa të përbashkëta kundër veprës së falsifikimit të monedhës.

Sipas parashikimeve të kësaj konvente, palët kontraktuese do të konsultohen në lidhje me problematikat që mund të lindin, brenda kuadrit ligjor vendas. Hetimet mbi subjektin e falsifikimit do të organizohen nga një Zyrë Qendrore, të cilat do të krijojnë komunikim të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën (nenet 78, 83, pika 1 dhe 121), si dhe është në harmoni me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk parashikon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Kjo Konventë bën të mundur realizimin e një hapi përpara drejt konsolidimit të kuadrit ligjor në fushën e falsifikimit të monedhës. Gjithashtu, me anë të aderimit vendi ynë merr përsipër të drejta dhe detyrime që lindin nga kuadri ndërkombëtar ligjor.

Konventa Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës është nënshkruar në Gjenevë, më 20 prill 1929, dhe ka hyrë në fuqi më 22 shkurt 1931.

Bashkëpunimi i palëve kontraktuese do të bëhet me anë të rregullave të parashikuara në këtë konventë. Kjo konventë është mjeti më efektiv për rrethanat aktuale që siguron parandalimin dhe dënimin e veprës së falsifikimit të monedhës.

Këto rregulla parashikohen në dispozitat e pjesës I.

Sipas kësaj Konvente, fjala “monedhë” nënkupton paratë letër (kartëmonedhat) dhe paratë metalike (monedhat), qarkullimi i të cilave është i autorizuar ligjërisht.

Veprat e dënueshme janë të listuara si më poshtë:

- Çdo bërje apo ndryshim mashtrues i parasë, pavarësisht se çfarë mjetes përdoren;

- Hedhja në qarkullim mashtrues i monedhës së falsifikuar;
- Futja në një vend, marrja ose përftimi i monedhës së falsifikuar me synim qarkullimin e tyre dhe duke pasur dijeni se janë të falsifikuara;
- Përpjekjet për të kryer dhe çdo pjesëmarrje e qëllimshme në aktet e mësipërme;
- Kryerja, marrja ose përftimi mashtrues i instrumenteve apo artikujve të tjerë të përshtatur posaçërisht për falsifikimin apo ndryshimin e parasë.

Aktet e lartpërmendura, nëse do të kryhen në shtete të ndryshme, konsiderohen si një vepër penale e veçantë.

Sipas kësaj konvente nuk bëhet asnjë dallim me shkallën e dënimeve për veprat e referuara si krime në fushën e falsifikimit të monedhës, të lartpërmendura, ndërmjet akteve që kanë të bëjnë me paratë vendase nga njëra anë dhe monedhës së huaj nga ana tjetër. Ky parashikim nuk mund të bëhet objekt i çfarëdo kushti trajtimi reciprok me ligj apo me traktat.

Në vendet ku njihet parimi i njohjes ndërkombëtare të dënimeve të mëparshme, dënimet e huaja për veprat e referuara në nenin 3, të Konventës, duhet të njihen nga legjislacioni vendas.

Pala e lartë kontraktuese (paratë e të cilave janë falsifikuar) gëzon të drejtat që u lejohen banorëve sipas ligjeve të vendit në të cilin rasti është gjykuar, për aq sa “palët civile” dhe “palë civile” të huaja (përfshirë, nëse është e nevojshme) janë të pranura sipas ligjit të brendshëm.

Për vendet ku nuk njihet parimi i ekstradimit të shtetasve, shtetasit që janë kthyer në territorin e vendit të tyre pasi kanë kryer një nga veprat e përmendura duhet të dënohen në të njëjtën mënyrë sikur vepra të ishte kryer në vetë territorin e tyre, edhe në rastin kur shkelësi ka marrë shtetësinë e tij pas kryerjes së veprës.

Të huajt, që kanë kryer jashtë vendit çfarëdo vepre të lartpërmendur dhe që janë në territorin e një vendi ku legjislacioni i brendshëm i të cilit njeh si rregull të përgjithshëm parimin e ndjekjes penale të veprave të kryera jashtë vendit, duhet të dënohen në të njëjtën mënyrë sikur vepra të ishte kryer në territorin e atij vendi.

Veprat e përmendura në nenin 3 konsiderohen si krime ekstradimi në çdo traktat ekstradimi që është bërë apo mund të bëhet më pas mes secilës nga palët e larta kontraktuese. Palët e larta kontraktuese, që nuk e bëjnë ekstradimin si kusht për ekzistencën e një traktati apo të reciprocitetit, i njohin më pas veprat e përmendura si raste ekstradimi mes tyre.

Ekstradimi do të lejohet në përputhje me ligjin e vendit të cilit i drejtohet kërkesa.

Paratë e falsifikuara, instrumentet apo artikuj të tjerë të përmendura në nenin 3(5) duhet të sekuestrohen dhe të konfiskohen. Pas konfiskimit, i dorëzohen pas një kërkesë qeverisë ose bankës që prodhon paranë, me përjashtim të provave, kur ligji vendas kërkon ruajtjen e tyre si dosje në vendin ku bëhet ndjekja penale, dhe çdo mostër/ kopje, transmetimi i të cilave të Zyra Qendrore konsiderohet e këshillueshme. Për çdo rast, të gjithë artikujt e tillë bëhen të papërdorshëm.

Në çdo vend, brenda kuadrit ligjor vendas, hetimet mbi subjektin e falsifikimit duhet të organizohen nga një zyrë qendrore. Kjo zyrë qendrore duhet të jetë në kontakt të ngushtë me:

- institucionet që nxjerrin/prodhojnë paratë;
- autoritetet policore brenda vendit;
- zyrat qendrore të vendeve të tjera.

Në çdo vend duhet të centralizohet informacioni i natyrës që lehtëson hetimin, parandalimin dhe dënimin e falsifikimit të monedhës.

Zyrat qendrore të vendeve të ndryshme duhet të komunikojnë drejtpërdrejt me njëra-tjetrën.

Zyra qendrore, si një instrument që përcjell shpejt informacion në zyrat qendrore të vendeve të tjera, përcjell një komplet të mostrave jashtë qarkullimit të parasë aktuale të vendit të tij.

Ajo njofton rregullisht zyrat qendrore në vendet e huaja, duke u dhënë të gjitha veçoritë e nevojshme si:

- prodhimet e parasë së re, të bëra në vendin e saj;
- tërheqjen e parasë nga qarkullimi, qoftë për arsye skadence apo tjetër.

Me përjashtim të rasteve me interes vendas, çdo zyrë qendrore njofton shpejt zyrat qendrore në vendet e huaja, për rastet, si më poshtë:

1. Çdo zbulim të monedhës së falsifikuar. Njoftimi i falsifikimit të kartave bankare apo të kartëmonedhave shoqërohet me një përshkrim teknik të falsifikimit dhe i dërgohet vetëm institucioneve të cilave u është falsifikuar paraja. Duhet të transmetohet një riprodhim fotografik ose, nëse është e mundur, një mostër e kartëmonedhës së falsifikuar. Në raste urgjente, një njoftim dhe përshkrim i shkurtër i bërë nga autoritetet policore mund t'u komunikohet me zgjuarsi zyrove qendrore të interesuara pa ndonjë paragjykim ndaj njoftimit dhe përshkrimit teknik të përmendur më lart.
2. Hetimi dhe ndjekjet penale në rastet e falsifikimit dhe arrestimet, dënimet e dëbimet e falsifikatorëve dhe, gjithashtu, kur është e mundur, lëvizjet e

tyre së bashku me çdo detaj që mund të jetë i dobishëm, si dhe, në veçanti, përshkrimi i tyre, gjurmët e gishtave dhe fotografitë;

3. Detaje të zbulimit të falsifikimit, duke sqaruar nëse ishte e mundur të sekuestrohej e gjithë paraja e falsifikuar e hedhur në qarkullim.

Për të siguruar, përmirësuar e zhvilluar një bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërkombëtar për parandalimin dhe dënimin e falsifikimit të parasë, përfaqësuesit e zyrave qendrore të palëve të larta kontraktuese organizojnë konferenca me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bankave paraprodhuese dhe të autoriteteve qendrore përkatëse. Organizimi dhe mbikëqyrja e zyrës qendrore të informacionit ndërkombëtar mund të përbëjë një ndër temat e këtyre konferencave.

Transmetimi i letërkërkesave lidhur me veprat e përmendura në Nenin 3 duhet të realizohet:

- a) mundësisht nëpërmjet një komunikimi të drejtpërdrejtë mes autoriteteve gjyqësore, aty ku është i mundshëm, nëpërmjet zyrave qendrore;
- b) nëpërmjet një korrespondence të drejtpërdrejtë mes ministrave të drejtësisë të të dyja vendeve ose nëpërmjet një komunikimi të drejtpërdrejtë prej autoritetit të vendit kërkues me ministrin e Drejtësisë të vendit që i drejtohet kërkesa;
- c) nëpërmjet përfaqësuesit diplomatik apo konsullor të vendit kërkues në shtetin të cilit i bëhet kërkesa, ky përfaqësues do t'i dërgojë letërkërkesën autoritetit kompetent gjyqësor ose autoritetit të caktuar nga qeveria e vendit që i bëhet kërkesa, dhe do të marrë drejtpërdrejt nga po ai autoritet dokumentet/letrat që tregojnë ekzekutimin e letër-kërkesës.

Në rastet e përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, një kopje e letërkërkesës do t'i dërgohet, njëkohësisht, autoritetit superior të vendit që i bëhet kërkesa.

Me përjashtim kur bihet dakord ndryshe, letërkërkesat do të hartohen në gjuhën e autoritetit që bën kërkesën, me kusht që vendi që merr kërkesën mund të kërkojë një përkthim në gjuhën e tij, të certifikuar korrektësisht nga autoriteti që bën kërkesën.

Secila palë e lartë kontraktuese do të njoftojë secilën prej palëve të tjera të larta kontraktuese mbi metodën apo metodat e transmetimit të përmendura më lart të cilat do të pranohen/njihen për letërkërkesat e palës së lartë kontraktuese të fundit.

Deri sa të bëhet një njoftim i tillë nga një palë e lartë kontraktuese, procedurat e saj ekzistuese lidhur me letërkërkesat mbeten në fuqi.

Në tërësi të kuptimit të kësaj konvente, ‘ekzekutimi i letërkërkesave’ nënkupton procedurat që lidhen me nenet 9 dhe 10 të kësaj konvente, që kanë lidhje me

parimin e ndjekjes penale të veprave të kryera jashtë vendit dhe ekstradimin, për të cilat neni 16 parashikon mënyrën e transmetimit dhe zbatimin apo ekzekutimin e letërkërkesave mbi veprat penale të kryera.

Nisur nga viti i hartimit të kësaj konvente, jemi përballë përdorimit të një terminologjie të vjetër, e cila ka evoluar me kohën dhe në aktet ligjore e nënligjore të ditëve të sotme njihen si ‘kërkesë’ dhe ‘letërporosi’, të kryera në kuadër të ndjekjes penale të veprave të kryera jashtë vendit dhe ekstradimit. Këto procedura në lidhje me veprat penale, objekt të kësaj konvente, do të njësohen me procedurat që ndiqen aktualisht për zbatim të akteve ligjore në fuqi, për të cilat nuk parashikohen taksa.

Këto parashikime nuk duhet të interpretohen si një angazhim nga palët e larta kontraktuese për të miratuar për çështjet penale të çfarëdo forme apo metode provash që bie ndesh me ligjet e tyre.

Pjesëmarrja e një pale të lartë kontraktuese në këtë Konventë nuk duhet interpretuar sikur ndikon në qëndrimin/pozicionin e një pale rreth çështjes së përgjithshme të juridiksionit penal si një çështje e ligjit ndërkombëtar.

Kjo Konventë nuk ndikon në parimin se veprat e përshkruara sipas kësaj konvente duhet që në secilin vend, pa lejuar asnjëherë pandëshkueshmëri, të përcaktohen, të ndiqen penalisht dhe të dënohen në përputhje me rregullat e përgjithshme të ligjit të tij vendas.

Pjesa II parashikon dispozitat përfundimtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente.

Ratifikimi ose anëtarësimi në këtë Konventë nga çdonjëra palë e lartë kontraktuese nënkupton që legjislacioni dhe organizimi i saj administrativ janë në përputhje me rregullat që përmban kjo Konventë.

Pas hyrjes në fuqi të Konventës, në përputhje me parashikimet, çdo ratifikim apo anëtarësim i mëpasshëm do të hyjë në fuqi ditën e nëntëmbëdhjetë pas marrjes së tij nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve.

Gjithashtu, kjo Konventë parashikon tërheqjen prej saj në emër të çdo anëtari të Lidhjes së Kombeve apo shteti joanëtar, duke njoftuar me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, duke parashikuar edhe procedurat e mëtejshme të njoftimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij akti janë Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë), si dhe Ministria e Drejtësisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës” është hartuar nga Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Konventa ngarkon me përgjegjësi për zbatimin palët nënshkruese të saj.

Kostoja financiare që do të lindë prej ngritjes së Zyrës Qendrore dhe veprimtarisë së saj do të jetë si më poshtë:

Ngritja e Zyrës Qendrore nuk do të ketë kosto shtesë, pasi do të pozicionohet në ndërtesën aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në buxhetin aktual të Policisë së Shtetit për vitin përkatës.

Edhe efekte financiare shtesë në lidhje me personelin nuk do të ketë, pasi punonjësit do të jenë pjesë e strukturës aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Veprimtaritë në kuadër të kësaj konvente do të kryhen nga dy specialistë në Sektorin kundër Pastrimit të Parave dhe Aseteve, në Drejtorinë për Krimet Ekonomike dhe Financiare, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, veprimtari e cila do të shtohet në procedurat e punës së sektorit dhe drejtorisë në fjalë.

Krijimi i kësaj qendre nuk do të sjellë mbivendosje me sektorët e tjerë që luftojnë krimin ekonomik e financiar në Policinë e Shtetit, pasi detyrat e qendrës janë të mirëpërcaktuara dhe të pavarura nga detyrat e sektorëve të tjerë.

KËSHILLI I MINISTRAVE